



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIRËMBAJTJES SË OBJEKTEVE PUBLIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2026

PROCESVERBAL

Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim

OBJEKTI I PROCEDURËS: "BLERJE VEGLA PUNE DHE PAJISJE PËR NDËRTIM"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
44510000-8 – Vegla.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,999,600 (Një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit 2, pika 2, shkronja "c", si dhe nenit 78, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, Bashkia Shkodër, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka hartuar këtë procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme janë vendosur në mbështetje të neneve 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit kërkohet për të provuar paraprakisht përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit nga operatorët ekonomikë, ndërsa Sigurimi i Ofertës kërkohet për të garantuar seriozitetin e ofertës dhe përmbushjen e detyrimeve të ofertuesit gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë

Operatori ekonomik duhet të plotësojë kërkesat për kapacitetin profesional nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Argumentimi

Kjo kërkesë është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë natyrën dhe objektin e procedurës së prokurimit, e cila konsiston në furnizimin me vegla pune dhe pajisje për ndërtim, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se përmbushja e kapacitetit profesional mund të provohet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Nuk janë vendosur kërkesa shtesë për kapacitetin profesional, pasi ato nuk konsiderohen të domosdoshme për realizimin e kontratës dhe do të ishin në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe nxitjen e konkurrencës, të parashikuara në legjislacionin për prokurimin publik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024 dhe 2025) duhet të jetë jo më e ulët se 799,840 (shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e dyzet) lekë, që përfaqëson 40% të vlerës së fondit limit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet financiare të kërkuara.

Argumentimi

Kjo kërkesë është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 43 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i xhiros minimale në masën **40% të vlerës së fondit limit**, konkretisht **799,840 (shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e dyzet) lekë**, është bërë në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën, objektin dhe vlerën e kontratës.

Ky kriter synon të vërtetojë se operatori ekonomik disponon kapacitetin ekonomik dhe financiar të nevojshëm për të përballuar furnizimin me mallrat objekt prokurimi dhe për të garantuar realizimin e kontratës në përputhje me kushtet e kërkuara, pa krijuar barriera të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Përcaktimi i periudhës prej **3 (tre) viteve financiare (2023, 2024 dhe 2025)** është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërsa mundësia që kriteri të konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin xhiron minimale në **të paktën një nga vitet financiare të kërkuara** siguron respektimin e parimit të proporcionalitetit, nxit konkurrencën dhe mundëson pjesëmarrjen e një numri sa më të gjerë operatorësh ekonomikë.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë përmbushur detyrimet për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025, si dhe këstet e maturuara të vitit 2026, për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet, sipas të dhënave të regjistruara në Qendrën

Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me afatet e pagesës të përcaktuara nga secila njësi e vetëqeverisjes vendore.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, dhe nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 26 dhe nenit 43, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kërkesa synon të verifikojë se operatori ekonomik ka përmbushur detyrimet për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet, sipas të dhënave të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), duke garantuar respektimin e legjislacionit fiskal në fuqi dhe rregullsinë fiskale të operatorit ekonomik.

Përcaktimi i vitit 2025 dhe i kësteve të maturuara të vitit 2026 është bërë në përputhje me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, si dhe me afatet e pagesës të miratuara nga secila njësi e vetëqeverisjes vendore, pa kërkuar shlyerjen e detyrimeve që nuk kanë arritur ende afatin ligjor të pagesës.

Kërkesa është në përputhje me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës, nuk kufizon konkurrencën dhe garanton trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë, duke mundësuar verifikimin e rregullsisë së tyre fiskale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 399,920 (treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë, që përfaqëson 20% të vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

- a. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 4, dhe nenit 55, pika 4, shkronja "b", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kërkesa për realizimin e furnizimeve të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **399,920 (treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë**, që përfaqëson **20% të vlerës së fondit limit**, është vendosur në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën, objektin dhe vlerën e kontratës.

Ky kriter synon të verifikojë se operatori ekonomik disponon përvojën e nevojshme në furnizimin e mallrave të ngjashme dhe ka aftësinë teknike e organizative për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përcaktimi i periudhës prej **3 (tre) viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe siguron që përvoja e paraqitur nga operatori ekonomik të jetë aktuale, e verifikueshme dhe e lidhur me objektin e prokurimit.

Kërkesa është në përpjesëtim të drejtë me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës, nuk kufizon konkurrencën dhe garanton trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët, fragmentet e katalogëve, skedat teknike (datasheet) ose dokumentacion tjetër teknik zyrtar të prodhuesit vetëm për mallrat për të cilat prodhuesi lëshon dokumentacion teknik dhe për të cilat ky dokumentacion është i nevojshëm për verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike.

Kjo kërkesë zbatohet për mallrat e mëposhtëm:

- Prerëse bari me benzinë;
- Sharrë krasitëse portative me bateri;
- Prerëse bari dhe ligustrash me bateri;
- Trapano elektrik;
- Gur fresues këndor Ø230 mm;
- Detektor tensioni;
- Gërshërë profesioniste për elektrikist;
- Prerës dhe zgjerues për tuba metalikë;
- Pompë vakumi me dy faza;
- Vegël për zhveshje telash;
- Vidator me bateri;
- Vinç manual për montim;
- Valixhe manometri + 3 tuba;
- Çelës universal për kabinete elektrike;
- Fryrës gjethesh me bateri;
- Sharrë horizontale me bateri;
- Zmeriluese trekëndore me bateri;
- Aspirator me depozitë inoksi;
- Trapan/Çekiç shpues me bateri;
- Kositëse bari me benzinë.

Dokumentacioni teknik duhet të identifikojë qartë produktin e ofertuar duke treguar emrin e prodhuesit, modelin, kodin ose referencën përkatëse.

Karakteristikat teknike të paraqitura në dokumentacion duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike.

Në rast se dokumentacioni është në gjuhë të huaj, pjesët që përmbajnë karakteristikat teknike duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 6, shkronja "b", të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Dokumentacioni teknik është kërkuar vetëm për mallrat për të cilat prodhuesit disponojnë katalogë ose skeda teknike dhe për të cilat verifikimi i karakteristikave teknike nuk mund të realizohet në mënyrë objektive pa dokumentacionin teknik përkatës.

Kjo kërkesë nuk është vendosur për mallrat standarde të konsumit ose materialet e ndërtimit që zakonisht nuk shoqërohen me katalogë teknikë të prodhuesit.

Kërkesa është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe nuk kufizon konkurrencën.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostra për mallrat e mëposhtëm pranë Autoritetit Kontraktor, në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, Bashkia Shkodër, në datën dhe orën e caktuar për hapjen e ofertave:

- Prerëse bari me benzinë;
- Kositëse bari me benzinë;
- Trapan/Çekiç shpues me bateri;
- Gur fresues këndor Ø230 mm;
- Sharrë krasitëse portative me bateri.

Mostrat duhet të jenë të reja, të papërdorura dhe të njëjta me produktet e ofertuara në ofertën ekonomike dhe dokumentacionin teknik.

Mostrat do të verifikohen nga Autoriteti Kontraktor për përputhshmërinë me specifikimet teknike dhe dokumentacionin teknik.

Çdo mostër duhet të jetë e identifikuar me:

- emrin e operatorit ekonomik;
- emrin e prodhuesit;
- markën;
- modelin ose kodin e produktit.

Mosparaqitja e mostrave ose paraqitja e mostrave që nuk përputhen me specifikimet teknike dhe dokumentacionin teknik përbën shkak për refuzimin e ofertës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Mostrat janë kërkuar vetëm për pajisjet kryesore të procedurës, të cilat për shkak të karakteristikave të tyre funksionale dhe teknike nuk mund të vlerësohen plotësisht vetëm nëpërmjet dokumentacionit teknik.

Verifikimi fizik i mostrave mundëson konstatimin e përputhshmërisë së produktit me specifikimet teknike, cilësinë e ndërtimit, funksionalitetin dhe identifikimin e produktit të ofertuar.

Kërkesa është kufizuar vetëm për pajisjet kryesore të procedurës dhe është në përpjesëtim të drejtë me natyrën, objektin dhe vlerën e kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi ose autorizim, të vlefshëm për këtë procedurë prokurimi, të lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar prej tij, të vlefshëm për këtë procedurë prokurimi, ku të specifikohet objekti dhe numri i referencës (REF) i procedurës. Për mallrat e mëposhtëm:

- Prerëse bari me benzinë;
- Kositëse bari me benzinë.

Në rast se autorizimi ose deklarata e furnizimit lëshohet nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që provon marrëdhënien e autorizimit ndërmjet prodhuesit dhe distributorit.

Deklarata e furnizimit ose autorizimi duhet të përmbajë të dhëna identifikuese të prodhuesit ose distributorit të autorizuar, të mjaftueshme për verifikimin e autenticitetit të dokumentit nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se kërkesa për paraqitjen e deklaratës së furnizimit ose autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar duhet të zbatohet vetëm për **prerësen e barit me benzinë** dhe **kositësen e barit me benzinë**, të cilat përfaqësojnë pajisjet kryesore të motorizuara objekt prokurimi dhe dallojnë nga mallrat e tjerë për shkak të kompleksitetit teknik, vlerës ekonomike dhe nevojës për mirëmbajtje gjatë përdorimit.

Këto pajisje do të përdoren nga Autoriteti Kontraktor për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes së hapësirave publike dhe, për shkak të funksionimit me motor me djegie të brendshme, kërkojnë garanci, mbështetje teknike, disponueshmëri të pjesëve të këmbimit dhe mundësi furnizimi gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka çmuar të nevojshme të verifikojë që operatori ekonomik disponon një burim të ligjshëm dhe të identifikueshëm furnizimi për këto pajisje, në mënyrë që të garantohet realizimi i kontratës në përputhje me kërkesat teknike dhe kontraktore.

Kjo kërkesë **nuk është vendosur për të provuar karakteristikat teknike të produkteve**, pasi këto verifikohen nëpërmjet katalogëve, dokumentacionit teknik dhe mostrave të kërkuara në kriteret përkatëse të Dokumenteve të Tenderit. Deklarata e furnizimit ose autorizimi kërkohet vetëm për të provuar mundësinë reale të furnizimit, origjinën e produktit dhe ekzistencën e një marrëdhënieje të verifikueshme me prodhuesin ose rrjetin e tij të autorizuar.

Autoriteti Kontraktor ka kufizuar këtë kërkesë vetëm për dy pajisjet e sipërcituara dhe nuk e ka shtrirë atë për mallrat e tjerë objekt prokurimi, me qëllim respektimin e parimit të proporcionalitetit dhe shmangien e vendosjes së kërkesave të panevojshme që mund të kufizojnë konkurrencën.

Pranimi i deklaratës së furnizimit ose autorizimit si nga prodhuesi, ashtu edhe nga distributori i autorizuar, garanton pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që furnizohen nëpërmjet kanaleve të ligjshme të tregtimit dhe nuk kufizon pjesëmarrjen vetëm të përfaqësuesit ekskluzivë të prodhuesit.

Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se kërkesa për deklaratë furnizimi ose autorizim nuk synon të kufizojë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, pasi pranohet dokument i lëshuar si nga prodhuesi, ashtu edhe nga distributori i autorizuar prej tij. Kjo u mundëson operatorëve ekonomikë pjesëmarrjen në procedurë edhe në rastet kur nuk janë përfaqësues ekskluzivë të prodhuesit, por furnizohen nëpërmjet rrjeteve të autorizuar të shpërndarjes.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe rëndësinë e mallrave për të cilat kërkohet dhe është i domosdoshëm për garantimin e realizimit të suksesshëm të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentin **"Ofertë Teknike"**, sipas modelit të paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në **Shtojcën 7** të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Dokumenti **"Ofertë Teknike"** duhet të përmbajë, për secilin produkt të ofertuar, të paktën këto të dhëna:

Nr.	Emërtimi i produktit	Emërtimi i prodhuesit	Emërtimi i katalogut ose skedës teknike	Referenca në katalog (Kodi i produktit ose nr. i faqes)	Shënime (nëse ka)
-----	----------------------	-----------------------	---	---	-------------------

Operatori ekonomik duhet të respektojë këto kërkesa:

- Emërtimi dhe renditja e produkteve duhet të jetë sipas listës së mallrave të paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7.
- Në kolonën "Emërtimi i katalogut ose skedës teknike" duhet të shënohet dokumenti teknik mbi të cilin mbështetet oferta.
- Në kolonën "Referenca në katalog" duhet të shënohet kodi i produktit ose, në mungesë të tij, numri i faqes ku gjendet produkti në katalog ose në skedën teknike.

- Në kolonën "Shënime", operatori ekonomik mund të japë informacion shtesë ose sqarime mbi produktet e ofertuara.

Të dhënat e pasqyruara në Ofertën Teknike duhet të jenë në përputhje me katalogët, skedat teknike dhe mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik.

Mosparaqitja e dokumentit "Ofertë Teknike" ose mosplotësimi i tij në atë masë që pamundëson identifikimin e produkteve të ofertuara dhe referencave përkatëse në dokumentacionin teknik, përbën shkak për refuzimin e ofertës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 6, shkronja "b", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentit "Ofertë Teknike" është vendosur për të lehtësuar identifikimin dhe vlerësimin e produkteve të ofertuara, duke krijuar një lidhje të qartë ndërmjet mallrave të ofertuara dhe dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik.

Plotësimi i këtij dokumenti mundëson një proces vlerësimi objektiv, transparent dhe të njëtrajtshëm, si dhe shmang paqartësitë gjatë verifikimit të përputhshmërisë së mallrave me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Kërkesa është në përputhje të drejtë me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi nuk kërkon dokumentacion teknik shtesë, por vetëm sistemimin dhe referimin e informacionit teknik të paraqitur.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në mbështetje të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë përgatitur duke marrë në konsideratë nevojat konkrete të Autoritetit Kontraktor për furnizimin me vegla pune, pajisje me motor, pajisje elektrike dhe materiale ndihmëse për ndërtim, të cilat do të përdoren për realizimin e punimeve të mirëmbajtjes së objekteve publike dhe të hapësirave në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike.

Karakteristikat teknike të përcaktuara për secilin artikull janë hartuar mbi bazën e funksionit që do të kryejë malli, kushteve të përdorimit, qëndrueshmërisë, cilësisë, sigurisë dhe performancës së kërkuar, me qëllim sigurimin e produkteve të përshtatshme për përdorim profesional dhe për realizimin e veprimtarisë së përditshme të Autoritetit Kontraktor.

Për mallrat që, për shkak të natyrës së tyre, disponojnë dokumentacion teknik të prodhuesit, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar paraqitjen e katalogëve, skedave teknike (datasheet) ose dokumentacionit tjetër teknik zyrtar, me qëllim verifikimin objektiv të përputhshmërisë së produkteve të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara.

Për një numër të kufizuar pajisjesh kryesore, për të cilat verifikimi vetëm nëpërmjet dokumentacionit teknik nuk është vlerësuar i mjaftueshëm, është parashikuar edhe paraqitja e mostrave, me qëllim verifikimin fizik të karakteristikave funksionale, cilësisë së ndërtimit dhe përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike. Kjo kërkesë është vendosur vetëm për pajisjet që, për shkak të natyrës dhe funksionit të tyre, kërkojnë një vlerësim praktik të karakteristikave teknike dhe nuk është shtrirë për mallrat standarde ose materialet e zakonshme të ndërtimit.

Për pajisjet me motor me benzinë, për të cilat garancia, mbështetja teknike dhe disponueshmëria e pjesëve të këmbimit janë elemente të rëndësishme për përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre, është kërkuar deklaratë furnizimi ose autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me qëllim garantimin e një burimi të ligjshëm furnizimi dhe mbështetjes teknike gjatë ekzekutimit të kontratës.

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë që të sigurojnë konkurrencë të hapur, trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim të operatorëve ekonomikë, pa favorizuar një prodhues, markë, origjinë ose proces të caktuar prodhimi. Çdo referencë ndaj standardeve, markave, origjinës, patentave ose karakteristikave teknike do të kuptohet e shoqëruar me shprehjen "**ose ekuivalente**", në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i specifikimeve teknike është bërë në bashkëpunim me specialistët e fushës, mbi bazën e nevojave reale të Autoritetit Kontraktor dhe në funksion të sigurimit të mallrave cilësore, funksionale, të sigurt dhe të përshtatshme për përdorim profesional, duke respektuar parimet e proporcionalitetit, konkurrencës dhe përdorimit me efektivitet të fondeve publike.

Njësia e Prokurimit

1. **Aurora Shkja**u – Kryetare
2. **Nikoleta Logu** – Anëtare
3. **Viktor Sheldija** – Anëtar